Siguri

Video me armë në Snapchat i kushton shtrenjtë – 19 vjeçarja dorëzon pistoletën në Gjakovë

Sinjali.com 01 Maj 2026 20:49

Një postim në rrjete sociale ka çuar në ndërhyrjen e Policisë në Gjakovë, mëson Sinjali.

Ngjarja ka ndodhur më 1 maj 2026 rreth orës 13:35 në rrugën "Gjon Buzuku", ku e dyshuara Premtime Delija kishte publikuar një video me armë zjarri në Snapchat.

Pas identifikimit, njësia e hetimeve së bashku me patrullën kanë shkuar në shtëpinë e saj, ku e njëjta ka pranuar veprimin dhe ka dorëzuar vullnetarisht një pistoletë dhe dy karikatorë të zbrazët.

Sipas deklarimit të saj, arma i përkiste babait, B.D, i cili është intervistuar në cilësinë e dëshmitarit. Ai ka deklaruar se posedon vetëm pëlqim për armën, por jo leje fizike.

Me udhëzim të Prokurorit kujdestar, rasti është iniciuar si "Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve", ndërsa e dyshuara është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.

All rights are reserved 2025, Copyright Sinjali.com